


## Statistikat Tregtare te Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Shqipërinë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) shkëmbimi tregtar me Shqipërinë<sup>1</sup>, nga viti në vit paraqitet një partner të rëndësishëm tregtar në veçanti të eksportet e mallrave. Për periudhën janar dhjetor 2025, deficit tregtar arrin në -126.8 milionë Euro, që paraqet një ulje prej 24.2% krahasuar me -167.2 milionë Euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti sillet rreth 55.8%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Shqipërinë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	168.6	125.2	171.0	159.9
Import	255.9	310.9	338.2	286.7
Bilanci tregtar	(87.3)	(185.7)	(167.2)	(126.8)
% e mbulimit	65.9%	40.3%	50.6%	55.8%
Rritje Exp. (v-m-v) %	52.5%	-25.7%	36.6%	-6.5%
Rritje Imp. (v-m-v) %	-3.3%	21.5%	8.8%	-15.2%
Bila. Treg. (v-m-v) %	-43.4%	112.8%	-10.0%	-24.2%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)


<sup>1</sup> Shqipëria, zyrtarisht Republika e Shqipërisë, është një shtet në Evropën Juglindore, me kryeqytet Tirana. Ka një sipërfaqe prej 28,749 km<sup>2</sup> me rreth 2.7 milion banor. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) Nominal për 2025 vlerësohet rrethë 30.3 miliardë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 11,235 \$ (dollar amerikan).

Analizuar në periudhën e fundit disavjeçare, kryesisht kemi një trend në rritje të eksporteve, ndërsa te importet nga një trend rritës kemi një ulje te dukshme në vitin e fundit(2025).

Si rezultat i këtij trendi, deficitit tregtar me Shqipërinë nga viti në vit regjistron trend në rënie, shkalla e mbulimit të importit me eksport është e lartë, duke arritur në 55.8 % në vitin 2025 nga 50.6% sa ishte në vitin 2024.

Kjo tregon se Kosova importon rreth 1.8 herë më shumë vlera mallrash se sa eksporton drejt Shqipërisë.

Figura 2. Eksport/Importi me Shqipërin sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Shqipëria nga viti në vite zë një vend të rëndësishëm në eksportin e Kosovës. Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara arrinë në 159.9 milionë Euro<sup>2</sup> apo 17.0% si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm, renditet e para në listën e 10 vendeve kryesore te eksportet.

Importi i mallrave nga Shqipëria arritën në 286.7 milionë Euro apo 4.1% si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm, renditet e gjashta në listën e 10 vendeve kryesore te importet.

## Struktura e Eksportit/Importit me Shqipërinë në 2024-2025 sipas Seksioneve-grup kapitujve


Sipas të dhënave nga Open\_DATA Doganat e Kosovës(DK) grupet kryesor të Eksportit për vitin 2025 përbëjnë: 20.4% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 20.1% Produktet

<sup>2</sup> Për qëllime te këtij raporti (vitin 2024) kemi marrë të dhënat e mallrave te exportuara te publikuara sipas ASK në vlerë 171.0 milion Euro.

Minerale, (struktura ne perqindje nga 46.9% v.2024 dhe në 20.1% në v.2025)<sup>3</sup>, 15.4% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 6.5% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 6.4% Artikujt të ndryshëm të prodhuar (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj), 6.0% Makineritë, pajisjet mekanike; pajisjet elektrike; 5.0% Kafshet e gjalla dhe produktet me origjinë prej kafshëve; 4.0% Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi etj. si pjesëmarrjen në eksportin për Shqipëri.

Te sektori -Produkte minerale rënie e strukturës në përqindje nga 46.9% (vitin 2024) në 20.1% (vitin 2025), vjen si pasojë e mospërputhjes metodologjike ndërmjet dy burimeve të të dhënave: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) regjistron 171.0 milionë Euro eksporte drejt Shqipërisë, ndërsa platforma Open Data e Doganës së Kosovës raporton 246.7 milionë Euro, ku diferenca prej rreth 76 milionë Euro ndikohet plotësisht nga trajtimi specifik i eksporteve të energjisë elektrike nën kodin tarifor 2716000000.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024 - 2025 sipas Seksioneve-grup kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open\_DATA Doganat e Kosovës (DK)


Rënia e eksporteve për -6.5% apo rreth 11.1 milionë euro më pak mallra të eksportuar në Shqipëri në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rënia te sektorët si, Produkte minerale etj.

Te Importet gjatë vitin 2025 kemi këtë renditje të grupeve kapitujve kryesor si në vijim: 55.4%, Produktet minerale, 12.0% Produkte bimore, 8.3% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre,

<sup>3</sup> Për vitin 2024 sipas OpenDATA; <https://dogana.rks-gov.net/OpenData/Index?id=4>, vlera e mallrave të eksportuar për në Shqipëri raportohet se është 246.7 milion Euro, (mospërputhje me ASK për rreth 76 milion Euro, lidhet me eksportet te Kodi 2716000000 - Energji elektrike).

pasuar me 7.3% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 5.9% Produktet industrive kimike apo industrive të lidhjeve, 3.0% Artikuj të ndryshëm të prodhuar; etj si pjesëmarrjen të importet nga Shqipëria.

Figura 4. Struktura e Importit 2024-2025 sipas Seksioneve-grup kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open\_DATA Doganat e Kosovës (DK)

Rënia e importeve për -15.2% apo rreth 51.5 milionë euro më pak mallra të importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rënia te sektori Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 31.6% në 8.3%).